



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE KULTURORE

Nr. 703 prot

Roskovec, më 22.08.2025

PROJEKT-VENDIM
NR 49. DATË 22.08 2025

PËR
MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË MUZEUT HISTORIK TË
ROSKOVECIT 2025 -2030

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, pika k “ Miraton norma,standarte e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik”, Ligjit Nr.9806, datë 17.9.2007 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” të rishikuar,Ligjit Nr. 27/2018 datë 17.5.2018 (i ndryshuar me Ligjin Nr.99/2024 datë 12.09.2024) “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Muzeu Historik i Roskovecit është themeluar me **Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 30.12.2020**, si një institucion publik në varësi të Bashkisë Roskovec.Bashkia Roskovec ka hartuar “Planin Strategjik të Zhvillimit të Muzeut Historik të Roskovecit 2025-2030”.

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:

1. Miratimin e “Planit Strategjik të Zhvillimit të Muzeut Historik të Roskovecit 2025-2030”.
2. Pas miratimit të Planit ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturore, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi.

Konceptoi:A.Cenaj

Miratoi:S.Çepele

Për Drejtorinë Juridike:S.Kuka

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR
Maksim Goga

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE KULTURORE

Nr. 783/1 prot

Roskovec, më 22.08.2025

Lënda: Relacion për projektvendimin “Për miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Muzeut Historik të Roskovecit 2025-2030”

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Bashkia Roskovec ka hartuar “Planin Strategjik të Zhvillimit të Muzeut Historik të Roskovecit 2025-2030”, një dokument që hartohet në zbatim të ligjit Nr. 27/2018 datë 17.5.2018 (i ndryshuar me Ligjin Nr.99/2024 datë 12.09.2024) “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Muzeu Historik i Roskovecit është themeluar me **Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 30.12.2020**, si një institucion publik në varësi të Bashkisë Roskovec. Ky vendim u bazua në kuadrin ligjor për vetëqeverisjen vendore dhe për trashëgiminë kulturore, duke njohur nevojën për një strukturë të dedikuar që të ruajë, dokumentojë dhe prezantojë historinë e zonës dhe vlerat identitare të komunitetit lokal.

Strategjia aktuale për periudhën **2025–2030** synon të përcaktojë një **vizion afatmesëm dhe afatgjatë për funksionimin, konsolidimin dhe zhvillimin** e muzeut si një qendër dinamike e trashëgimisë kulturore, historisë vendore, edukimit qytetar dhe turizmit kulturor.

Qëllimi parësor i strategjisë është:

- **Konsolidimi i muzeut si institucion** me identitet të qartë, staf të specializuar dhe mjete të përshtatshme për përmbushjen e funksioneve të tij.

- **Grumbullimi, dokumentimi, konservimi dhe ekspozimi i objekteve** dhe materialeve historike që pasqyrojnë jetën shoqërore, kulturore, ekonomike dhe politike të banorëve të Roskovecit ndër shekuj.
- **Zhvillimi i funksionit edukativ dhe shkencor të muzeut**, duke ofruar platforma të përshtatshme për të rinjtë, studiuesit, mësuesit dhe vizitorët.
- **Nxitja e turizmit kulturor**, duke e integruar muzeun në rrjetet rajonale të vizitueshmërisë dhe duke promovuar Roskovecin si një destinacion kulturor dhe historik.

Vizioni

Vizioni i Muzeut Historik të Roskovecit është që të bëhet një qendër model kombëtare dhe rajonale për ruajtjen, promovimin dhe edukimin mbi trashëgiminë historike e kulturore të trevës së Roskovecit. Muzeu synon të jetë më shumë sesa një institucion statik – ai do të transformohet në një hapësirë të hapur, të gjallë dhe interaktive, ku e shkuara ndërvepron me të tashmen për të ndërtuar një të ardhme më të vetëdijshme dhe të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, muzeu do të shërbejë si:

- Një arkiv fizik dhe digjital i kujtesës kolektive, ku do të ruhen objektet, dokumentet, dëshmitë gojore dhe ikonografia e pasur e zonës.
- Një qendër kulturore edukative, e orientuar drejt nxënësve, studentëve, studiuesve dhe komunitetit të gjerë, përmes programeve mësimore, trajnimeve, ekspozitave tematike dhe aktiviteteve ndërvepruese.
- Një destinacion turistik i identitetit lokal, i integruar në rrjetin e promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare, që ofron përvoja autentike për vizitorët vendas dhe të huaj.

Në mënyrë të veçantë, muzeu synon të jetë pikë referimi për brezat e rinj, duke i lidhur ata me rrënjët historike të komunitetit, dhe duke i edukuar për vlerat e identitetit lokal, respektin për trashëgiminë dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në ruajtjen e saj.

Misioni

Misioni i Muzeut Historik Roskovec është që të **ruajë, mbrojë, dokumentojë, studiojë dhe promovojë trashëgiminë kulturore materiale dhe shpirtërore** të trevës së Roskovecit dhe zonës përreth. Duke përfshirë qytetin, fshatrat dhe njësitë administrative, muzeu synon të mbledhë dëshmitë historike që përfaqësojnë jetën, punën, luftën, zakonet dhe zhvillimin e shoqërisë lokale ndër shekuj.

Përmbushja e këtij misioni do të realizohet përmes:

- **Koleksionimit dhe konservimit profesional** të objekteve me vlerë historike, etnografike, arkeologjike dhe artistike;

- **Hulumtimit dhe studimit shkencor**, për të ndriçuar aspekte të panjohura ose të harruara të historisë lokale;
- **Edukimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit**, sidomos të brezit të ri, përmes programeve arsimore dhe aktiviteteve ndërevepruese;
- **Bashkëpunimit me institucione të ngjashme vendore e ndërkombëtare**, për shkëmbim përvojash dhe zhvillim të kapaciteteve;
- **Krijimit të hapësirave për dialog kulturor**, përfshirje qytetare dhe zhvillim të qëndrueshëm përmes trashëgimisë.

Objektivat strategjikë

Në përputhje me misionin dhe vizionin e përcaktuar, strategjia e zhvillimit të Muzeut Historik Roskovec për periudhën 2025–2030 parashikon pesë objektiva strategjikë kryesorë. Këto objektiva janë të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe synojnë krijimin e një institucioni të qëndrueshëm, të aksesueshëm dhe me ndikim të gjerë kulturor, edukativ dhe ekonomik. Objektivat strategjikë janë si më poshtë:

1-Rritja e kapaciteteve institucionale

2-Zgjerimi dhe sistemi i koleksioneve

3-Promovimi dhe vizibiliteti

4-Edukimi dhe përfshirja e komunitetit

5-Turizmi kulturor dhe zhvillimi ekonomik

1-Rritja e Kapaciteteve Institucionale

Rritja e kapaciteteve organizative është baza mbi të cilën do të ndërtohet funksionimi i plotë dhe profesional i muzeut. Një institucion muzeal modern duhet të jetë i pajisur me struktura të qarta, staf të trajnuar dhe mjete teknologjike bashkëkohore.

Objektiva specifike:

- **Konsolidimi i strukturës organizative:** Finalizimi i organigramës, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni; sigurimi i burimeve njerëzore të mjaftueshme për funksione kyçe si konservimi, edukimi, marketingu dhe administrimi.

- **Trajnimi i stafit muzeor:** Hartimi i një programi trajnimi të vazhdueshëm për stafin ekzistues dhe të ardhshëm në fushat e konservimit të objekteve, arkivistikës, menaxhimit të koleksioneve, komunikimit me publikun dhe përdorimit të teknologjive digjitale.
- **Pajisja me teknologji moderne:** Investimi në softuerë muzeor (p.sh. koleksione dixhitale, menaxhimi i vizitorëve, katalogim elektronik), pajisje sigurie, pajisje për konservim, si dhe mjetet audio-vizive për përvoja interaktive.
- **Hartimi i një rregulloreje të brendshme** që përshkruan procedurat operacionale, etikën muzeale dhe standardet e performancës.

2-Zgjerimi dhe Sistemi i Koleksioneve

Koleksioni është zemra e çdo muzeu. Pa një koleksion të pasur, të sistemuar dhe të dokumentuar mirë, funksioni i muzeut mbetet i paplotë. Objektivi është që Muzeu Historik Roskovec të ndërtojë një fond të rëndësishëm, autentik dhe përfaqësues të trashëgimisë së zonës.

Objektiva specifike:

- **Inventarizimi i plotë i objekteve** ekzistuese sipas metodologjive kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë klasifikimin sipas tipologjisë, periudhës, origjinës dhe gjendjes fizike.
- **Katalogimi elektronik** në një sistem të integruar të bazës së të dhënave me akses të kontrolluar për përdorues të ndryshëm (publiku, studiuesit, administrata muzeale).
- **Grumbullimi i objekteve të reja:** Përmes donacioneve nga qytetarët, gjetjeve të reja, bashkëpunimeve me institucione dhe blerjeve me prioritet të lartë muzeor.
- **Krijimi i një laboratorit të vogël konservimi** për restaurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të ndjeshme.
- **Përfshirja e dëshmimeve gojore dhe dokumenteve arkivore** si pjesë e fondit historik – me qëllim ruajtjen e kujtesës kulturore të komunitetit.

3-Promovimi dhe Vizibiliteti

Një nga sfidat kryesore për muzeumet lokale është vizibiliteti dhe mungesa e njohjes nga publiku i gjerë. Objektivi është që Muzeu Historik Roskovec të ndërtojë një identitet të qartë vizual, të jetë i njohur në mjedisin lokal dhe rajonal, si dhe të bëhet pjesë e rrjeteve kombëtare të trashëgimisë.

Objektiva specifike:

- **Zhvillimi i identitetit vizual:** Krijimi i logos zyrtare të muzeut, dizajni i materialeve informuese (broshura, postera, flamuj) dhe ndërtimi i një prezence të qëndrueshme në rrjetet sociale dhe në media.

- **Hapja e faqes zyrtare të muzeut** me informacion për koleksionet, aktivitetet, historinë e zonës, guida virtuale dhe sistem prenotimi për vizita.
- **Pjesëmarrja në aktivitete kulturore** si panaiare kombëtare të trashëgimisë, forume kulturore, ekspozita ndërmuzeale dhe evente ndërkombëtare që rrisin praninë dhe partneritetet.
- **Krijimi i ekspozitave të lëvizshme** që mund të shfaqen në shkolla, qendra komunitare dhe hapësira publike në të gjithë bashkinë, si mjet ndërgjegjësimi dhe edukimi.
- **Publikimi i materialeve të specializuara:** libra, albume, katalogë, dhe video dokumentare që dokumentojnë historinë lokale dhe përhapin njohuri për komunitetin dhe më gjerë.

4-Edukimi dhe Përfshirja e Komunitetit

Roli edukativ i muzeut është thelbësor për ndërtimin e një komuniteti të vetëdijshëm dhe aktiv në ruajtjen e trashëgimisë. Përfshirja e brezave të rinj, mësuesve, familjeve dhe aktorëve lokalë është pjesë integrale e kësaj strategjie.

Objektiva specifike:

- **Hartimi i një programi edukativ për shkollat** që përfshin vizita të organizuara me guida të personalizuar, punëtori për nxënës, lojëra edukative dhe bashkëpunim me mësuesit për integrimin e përmbajtjes muzeale në kurrikulën shkollore.
- **Krijimi i një "klubi muzeal të të rinjve"**, ku nxënësit e shkollave të mesme dhe të larta angazhohen si vullnetarë, ndihmojnë në aktivitete dhe mësojnë për ruajtjen e trashëgimisë.
- **Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për komunitetin lokal** mbi historinë dhe kulturën e zonës, mbledhjen e kujtimeve familjare, mbrojtjen e monumenteve, etj.
- **Partneritete me universitete dhe qendra kërkimore**, për zhvillimin e projekteve shkencore, ekspeditave arkeologjike dhe praktikave profesionale në muze.
- **Muzeu si hapësirë komunitare:** mikpritje e koncerteve tradicionale, leximeve publike, festivaleve kulturore dhe netëve dokumentare, për të krijuar një marrëdhënie të përhershme mes qytetarëve dhe muzeut.

5-Turizmi Kulturor dhe Zhvillimi Ekonomik

Muzeu ka potencialin të ndikojë pozitivisht në ekonominë lokale përmes zhvillimit të turizmit kulturor dhe promovimit të produkteve lokale. Ai do të jetë pjesë e një strategjie më të gjerë për të rritur vizitat në zonë dhe për të promovuar identitetin lokal si vlerë ekonomike.

Objektiva specifike:

- **Përfshirja e muzeut në rrjetin rajonal të turizmit kulturor**, përmes bashkëpunimeve me agjenci turistike, guida lokale dhe strukturat akomoduese në zonë.
- **Krijimi i itinerareve kulturore** që përfshijnë muzeun, monumentet e trashëgimisë kulturore, rrugët historike, vendet arkeologjike, kishat, xhamitë dhe natyrën përreth.
- **Zhvillimi i hapësirave komerciale në muze** për shitjen e suvenireve autentike, botimeve historike, riprodhimeve artizanale dhe produkteve artizanale të zonës.
- **Organizimi i tureve tematikë të udhëhequra** nga guida lokale që janë trajnuar nga muzeu, duke krijuar mundësi punësimi të të rinjve dhe zhvillim të sipërmarrjes sociale.
- **Krijimi i kalendarit të ngjarjeve sezonale**, si Dita e Trashëgimisë së Roskovecit, Javët Kulturore, ekspozita për festat kombëtare, etj., për të tërhequr vizitorë dhe për të krijuar impakt ekonomik dhe social.

Për këtë material, u zhvillua një konsultim publike në sallën e Këshillit Bashkiak ku të gjitha propozimet e diskutuara u reflektuan tek “Plani Strategjik i Zhvillimit të Muzeut Historik të Roskovecit 2025-2030”.

Për sa më sipër, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 54, shkronja “k”, Ligjit Nr.9806, datë 17.9.2007 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” të rishikuar, Ligjit Nr. 27/2018 datë 17.5.2018 (i ndryshuar me Ligjin Nr.99/2024 datë 12.09.2024) “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” kërkojmë nga Këshilli Bashkiak:

1-Miratimin e “Planit Strategjik të Zhvillimit të Muzeut Historik të Roskovecit 2025-2030”. sipas materialit bashkëngjitur.

2-Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturore, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Konceptoi: A. Ceqaj

Miratoi: S. Çepele

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDESKRYETAR**
Maksim Goga

KRYETAR
Majlinda Bufi